



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 679, Datë 14.02.2020

“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.02.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare.

Baza Ligjore: Nenet 24 shkronja (d), 26 dhe 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi monitorimin e tregut me pakicë të shërbimeve celulare”,

VËREN SE :

Pranë Autoritetit të Konkurrencës ndërmarrja Albtelecom me shkresën nr. 453/6 prot., datë 20.01.2020 dhe ndërmarrja Telekom Albania me shkresat me nr. 150/14 prot., datë 29.01.2020 dhe nr. 84 prot., datë 10.02.2020 kanë njoftuar Autoritetin e Konkurrencës mbi ndryshimet në çmim dhe përmbajtje të paketave të ofruara për programet me parapagesë (dhe ato me kontratë për individë, Telekom Albania).

Lidhur me ndryshimet e paketave celulare 30 ditore me parapagesë, pranë Autoritetit të Konkurrencës, janë paraqitur edhe dy ankesa nga konsumatorë të telefonisë celulare, si dhe nëpërmjet shkresës nr. 91 prot, datë 13.02.2020, është paraqitur një ankesë nga Qendra “Konsumatori Shqiptar” nëpërmjet së cilës pretendohet se kompanitë celulare kanë rritur çmimet në mënyrë të pajustificuar, pa informuar konsumatorët e telefonisë celulare dhe në dëm të interesave ekonomike të këtyre konsumatorëve.

Bazuar sa më sipër si dhe nisur nga shqetësimet në masmedia mbi rritjen e çmimit të paketave celulare 30 ditore me parapagesë me 200 lekë, Autoriteti i Konkurrencës në bazë të nenit 28 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, vendosi të realizojë një monitorim në këtë treg në lidhje me çmimin e paketave mujore që hidhen në treg nga operatorët celular Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Altelecom.

Nga monitorimi në terren pranë pikave të Vodafone Albania, Altelecom dhe Telekom Albania, si dhe nga shqyrtimi dhe vlerësimi i shkresave dhe ankesave të paraqitura, u konstatua se të tre operatorët celularë kanë hedhur në treg paketat e reja standarde 30 ditore me parapagesë me një rritje në çmim prej 200 lekësh, si dhe kanë rritur vlerën minimale për rimbushjeje me 100 leke, nga 100 në 200 lekë, në periudhën kohore 30 Janar – 11 shkurt 2020, sjellje e cila në kuptim të nenit 4, pika 1, gërma (a) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, mund të përbëjë një marrëveshje të ndaluar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4 dhe 9, nenin 24 shkronja (d), dhe nenin 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në “Tregun me pakicë të shërbimeve celulare”, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
- II. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 Nëntor 2019 deri në 31 Mars 2020.
- III. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 2 (dy) muaj nga marrja e këtij vendimi.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS